



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

**RREGULLORE E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT
“BACHELOR” NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021**

1. Të drejtën për të konkurruar e gëzojnë të gjithë nxënësit që janë diplomuar në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe në arsimin e mesëm profesional sportiv ose jo sportiv, të cilët kanë përfunduar konform rregullores së MAS, detyrime të Maturës Shtetërore në vitin akademik 2019 – 2020.
2. Mbështetur në VKM Nr. 436 dt. 03.06.2020, kanë të drejtë të regjistrohen për të konkurruar të gjithë kandidatët që kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm dhe sipas pikes 3 të kësaj VKM-je **“Përrjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare** kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, **kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit**, si dhe kandidatët me origjinë nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci”.
3. Data e konkurrimit si dhe kuota e pranimit, përcaktohen nga Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”.
4. Rregulloren e konkurrimit, Normat e pranimit, në programin e studimit "Bachelor" në Edukim fizik dhe sporte si dhe Skedën Shëndetësore Individuale, të interesuarit mund ta gjejnë në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit “A. Xhuvani”, www.uniel.edu.al. Gjithashtu një kopje do e tërheqin në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në momentin e regjistrimit për konkurrim. Bashkëngjitur do të gjeni skedën e kontrollit shëndetësor dhe datën e caktuar për fillimin e regjistrimit për konkurrim, si dhe datën e zhvillimit të konkursit.
5. Konkuruesit që rezultojnë me probleme të shëndetit, humbasin të drejtën e përfshirjes në konkurrim.
6. Njoftimi për datën, orën dhe vendin e organizimit të konkurrimit, shpallet dy javë para datës së konkurrimit. Njoftimi shpallet në median vizive e të shkruar. Ju mund ta kërkonti atë edhe në adresën e internetit të UE, www.uniel.edu.al.
7. Konkuruesit të paraqiten në konkurrim me uniformë sportive.
8. Dokumentat e vlefshme për regjistrim janë:

- Dokument personal identifikimi me fotografi.(Kartë identiteti,ose Pasaporte dhe fotokopje e saj).
 - Skeda shëndetësore e dhënë nga institucioni,e cila vërteton gjendjen shëndetësore të konkurrestit në përballimin e sforcimeve fizike,e plotësuar nga mjekë të specialitetit në rrethin ku i interesuari banon.
 - Dy fotografi.
 - Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit.
9. Konkurruesi përfiton 60% të pikëve nga konkurrimi sportiv dhe 40% të pikëve nga rezultati i maturës shtetërore.
10. Rezultati shumë i mirë vetëm në një disiplinë sportive ndikon, por jo domosdoshmërisht vendos për suksesin e konkurrestit.
11. Numri maksimal i pikëve në konkursin praktik është 70 pikë:
- Atletikë 18 pikë (6 pikë vrapimi 100 m, 6 pikë vrapimi 800 m dhe 6 pikë kërcimi nga vendi.
 - Gjymnastikë 17 pikë (9 pikë akrobaci dhe 8 pikë kërcim kaluçi)
 - Basketboll 18 pikë (9 pikë cirkuidi dhe 9 pikë gjuajtje të lira)
 - Volejboll 17 pikë (9 pikë shërbimet dhe 9 pikë pasimet)
12. **Konkurresti duhet të grumbullojë minimumi 15 pikë** për t'u kualifikuar në konkursin praktik.
13. Sasia e pikëve të grumbulluara nga konkurresti në 4 disiplinat sportive: Atletikë, Gjymnastikë, Volejboll, Basketboll, si rregull mbledhen me pikët e përftuara nga matura shtetërore. Shuma e këtyre pikëve do të përbëjë rezultatin përfundimtar të pikëve që grumbullon çdo konkurrest.

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

DEKANI

Doc. dr. Edmond BIÇOKU

Prof.as.dr.Valentina HAXHIYMERI